

FUQIZIMI I MBIKËQYRJES PARLAMENTARE NDAJ DIALOGUT KOSOVË-SERBI

NËNTOR, 2020



FUQIZIMI I MBIKËQYRJES PARLAMENTARE NDAJ DIALOGUT KOSOVË-SERBI

NËNTOR, 2020

E drejta e autorit © 2020. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Layout and design: **envinion**

Autore: Violeta Haxholli

Vërejtje: Kjo analizë është realizuar në kuadër të projektit *"Promovimi i një procesi të mirë informuar dhe pjesëmarrës në fazën finale të dialogut Kosovë-Serbi"*, i mbështetur nga Ambasada e Zvicrës dhe Ambasada Gjermane në Kosovë.

Përbajtja e kësaj analize është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Ambasadës Zvicerane dhe Ambasadës Gjermane në Prishtinë.

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE.....	6
2.	MEKANIZMAT MBIKËQYRËS PARLAMENTAR SIPAS LEGJISLACIONIT NË FUQI	8
	2.1 Mbikëqyrja parlamentare e dialogut përmes rezolutave.....	9
	2.2 Kuvendi përtej mandatit të tij mbikëqyrës ndaj dialogut me Serbinë.....	12
3.	TEMA E DIALOGUT NË KUVEND: TEJKALIMI I DALLIMEVE PARTIAKE DHE FOKUSI TEK TRANSPARENCA E DIALOGUT	13
4.	PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME	18
	Shtojcë 1: Mbikëqyrja Parlamentare e dialogut në numra	20
	Shtojcë 2: Marrëveshjet e dialogut sipas fushëveprimit të Komisioneve Parlamentare	22



1. HYRJJE

Procesi i dialogut mes Kosovës dhe Serbisë ka filluar me 9 mars 2011 pas miratimit të rezolutës në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara,¹ e cila mirëpriste gatishmërinë e Bashkimit Evropian që të ndërmeretonte një dialog mes Kosovës dhe Serbisë. Në kuadër të dialogut teknik u arritën shtatë konkluzë, lidhur me lëvizjen e lirë, regjistrat civil, regjistrat kadastral, IBM-in, përfaqësimin rajonal, njohjen reciproke të diplomave dhe vulën doganore. Më pas procesi i dialogut në tetor të vitit 2012 avancoi nga dialog teknik në atë politik, duke përfshirë edhe diskutime mbi çështje tjera të brendshme të Kosovës siç ishte veriu i vendit. Në kuadër të dialogut politik, me 19 prill 2013 u arrit Marrëveshja e Parë e parimeve për normalizimin e marrëdhënieve, e vetmja marrëveshje e cila u soll në Kuvendin e Kosovës për ratifikim. Pas marrëveshjes së prillit u arritën edhe marrëveshje tjera, shumica prej të cilave ishin derivate të marrëveshjes së parë. Statusi juridik i marrëveshjeve të arritura para dhe pas marrëveshjes së prillit ka mbetur i paqartë. Deri më tani në kuadër të dialogut janë arritur gjithsej rreth 38 marrëveshje.

Në vitin 2017 procesi i dialogut hyri në një fazë të re që po quhej faza finale e këtij procesi, qëllimi i së cilës ishte arritja e një marrëveshje përfundimtare ligjërish e obligueshme mes palëve. Ende pa filluar mirë, kjo fazë u ndërpre në fund të vitit 2018 pas vendosjes së tarifës 100% nga ana e Kosovës ndaj mallrave të Serbisë. Kjo e fundit kushtëzoi rikthimin në dialog me tërheqjen e tarifës. Në mars të vitit 2020 tarifa u zëvendësua me masa të reciprocitetit gjë që pasoi me refuzim të serishëm të Serbisë

për vazhdim të dialogut. Megjithatë, përfshirja më aktive e SHBA-ve në procesin e dialogut në janar dhe shkurt të vitit 2020, rezultoi me nënshkrimin e tri letrave të qëllimit mes palëve, për ri vitalizimin e linjës ajrore, hekurudhore dhe autostradave. Por, dialogu si proces për arritjen e marrëveshjes finale nuk vazhdoi deri pas shfuqizimit të të gjitha masave tregtare të vendosura nga ana e Kosovës në qershor 2020. Kjo rezultoi me takimin e palëve në Shtëpinë e Bardhë në Uashington, me ç'rast nënshkrimin e presidentit amerikan u arrit edhe marrëveshja e re në formë të zotimeve unilaterale për normalizim të raporteve ekonomike. Në anën tjetër procesi ka vazhduar edhe në Bruksel ku po negociohet për elementet e marrëveshjes finale.

Që nga fillimi i dialogut, Kuvendi është përpjekur që të ushtrojë rolin e tij mbikëqyrës kryesisht përmes debateve parlamentare, interpelancave, ftesave në raportim të përfaqësuesve të Qeverisë dhe rezolutave lidhur me dialogun. Deri më tani në Kuvend janë miratuar gjithsej 15 rezoluta të ndërlidhura me procesin e dialogut me Serbinë, nëpërmjet të cilave është synuar autorizimi i Qeverisë lidhur me udhëheqjen e dialogut si dhe për adresimin e çështjeve të ndryshme të dala nga ky proces. Me anë të këtyre rezolutave Kuvendi me raste ka tejkuluar mandatin e tij kushtetues si institucion mbikëqyrës i politikës së jashtme, duke ndërhyrë në kompetencat ekzekutive. Këto kompetenca janë sqaruar përfundimisht nga aktgjykimi i fundit i Gjykatës Kushtetuese lidhur me dialogun gjatë interpretimit të Ligjit për Delegacionin Shtetëror, ekip ky i cili ishte themeluar nga Kuvendi fillimisht me anë të një

1 Organizata e Kombeve të Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, Rezoluta A/RES/64/298", 9 shtator 2010. I qasshëm në, http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/64/298



rezolute në dhjetor 2018 e më pas edhe miratimit të ligjit në fjalë.

Roli i Kuvendit mbetet thelbësor edhe në këtë fazë finale të dialogut. Deri më tani procesi është mbajtur në një masë të madhe larg syve të Kuvendit dhe publikut dhe ka pasur pak informacione për temat që janë diskutuar dhe janë dakorduar deri më tani mes palëve në Bruksel. Në këtë drejtim edhe Kuvendi nuk ka arritur të garantojë mbikëqyrje efektive, transparencë dhe llogaridhënie të ekzekutivit lidhur me këto zhvillime.

Prandaj, nevoja për fuqizimin e mbikëqyrjes parlamentare ndaj procesit të dialogut Kosovë-Serbi është në fokus të kësaj analize. Përgjatë tre kapitujve analiza paraqet një përmbledhje të asaj se si e ka ushtruar Kuvendi rolin e tij mbikëqyrës ndaj dialogut deri më tani. Si dhe ofron rekomandime konkrete për deputetët e Kuvendit për të përbushur në mënyrë efektive mandatin e tyre mbikëqyrës ndaj këtij procesi.



Që nga fillimi i dialogut, Kuvendi është përpjekur që të ushtrorë rolin e tij mbikëqyrës kryesisht përmes debateve parlamentare, interpelancave, ftesave në raportim të përfaqësuesve të Qeverisë dhe rezolutave lidhur me dialogun.



Neni 65 i Kushtetutës lidhur me kompetencat e Kuvendit,



pika 12 thotë shprehimisht që 'Kuvendi mbikëqyr politikën e jashtme dhe të sigurisë'.

Kushtetuta përcakton gjithashtu që Kuvendi ratifikon traktatet ndërkombëtare, e cila rregullohet me anë të ligjit për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

janë listuar kryesisht tek komisioni për punë të jashtme. Rregullorja e punës përcakton shprehimisht që ky komision përcjellë negociatat e udhëhequra nga Qeveria për bashkëpunim marrje të saj në traktatet e reja dhe e nis debatin për ratifikimin e tyre. Si dhe mbikëqyr veprimet e Qeverisë në planin e politikës së jashtme.⁶ Mirëpo, procesi dhe marrëveshjet e dialogut kanë rregulluar fusha të ndryshme të cilat bien në fushëveprimin edhe të komisioneve tjera parlamentare. Rrjedhimisht, çështja e njohjes së diplomave bie në fushëveprimin e komisionit për arsim, ajo e energjisë në komisionin për zhvillim ekonomik, Ura e Mitrovicës në komisionin për planifikim hapësinor e kështu me radhë.

Kuvendi ka miratuar rezoluta për procesin e dialogut para fillimit të çdo faze të dialogut. Që nga viti 2011 në Kuvend janë miratuar katër rezoluta për fazat e dialogut. Mirëpo, gjatë kësaj periudhe janë miratuar edhe 11 rezoluta të tjera lidhur me aspekte apo tema të veçanta të ndërlidhura me dialogun dhe marrëdhëniet me Serbinë. Ato kanë adresuar çështjen e të pagjeturve, energjisë, gjendjes në veriun e vendit dhe të drejtat e shqiptarëve në Luginën e Preshevës.⁸

2.1 Mbikëqyrja parlamentare e dialogut përmes rezolutave

Mbi bazën e dispozitave kushtetuese, Kuvendi synoi të materializojë më tutje rolin e tij mbikëqyrës qysh në fillim të procesit të dialogut me Serbinë, me anë të rezolutave.⁷

Rezoluta e parë e ndërlidhur direkt me procesin e dialogut në mes Kosovës dhe Serbisë është miratuar në Kuvend me 10 mars 2011, një ditë pas fillimit të dialogut teknik me Serbinë. Ajo përcaktonte mënyrën e mbikëqyrjes së dialogut nga komisionet përkatëse dhe në seanca të Kuvendit. Me anë të kësaj rezolute përcaktohej, ndër të tjera, raportimi i përfaqësuesve qeveritar në Kuvend për procesin e dialogut, në komisionin parlamentar për punë të jashtme dhe komisionet tjera përkatëse.⁹

Kuvendi miratoi një **rezolutë të dytë** për procesin e dialogut me Serbinë në vitin 2012 pasi dialogu teknik kishte

6 Po aty, fq.45.

7 Rezoluta është mocion i shkruar me të cilin Kuvendi me anë të votimit e shpreh vullnetin e vet për një çështje të caktuar. Shih Rregulloren e Kuvendit fq.40.

8 Shih infografikën e KDI-së lidhur me rezolutat e miratuara rreth dialogut në, <http://www.votaim.org/Public/Article?InfoDialog=true&InfoDialog=false&SelectedTab=Infographics&InfoSelectedMonthID=&InfoSelectedYear=>

9 Rezolutë për dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, 10 mars 2011 në, http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezoluta_per_dialogun_midis_R.Kosoves_dhe_R.Serbise_2.pdf



Kuvendi ka miratuar rezoluta për procesin e dialogut para fillimit të çdo faze të dialogut. Që nga viti 2011 në Kuvend janë miratuar katër rezoluta për fazat e dialogut.

Rezoluta

1

E ndërlidhur direkt me procesin e dialogut në mes Kosovës dhe Serbisë është miratuar në Kuvend me 10 mars 2011, një ditë pas fillimit të dialogut teknik me Serbinë.

Rezoluta

2

Kuvendi miratoi një rezolutë të dytë për procesin e dialogut me Serbinë në vitin 2012 pasi dialogu teknik kishte evoluar në të ashtuquajturin dialog politik.

Rezoluta

3

Pas fillimit të fazës së re të dialogut në vitin 2017 rreth një vit më vonë, me 15 dhjetor të vitit 2018 në Kuvend u miratua rezoluta e tretë mbi fazën finale të dialogut.

Rezoluta

4

Pas rezolutës së dhjetorit 2018, në Kuvend është miratuar edhe rezoluta e katërt lidhur me procesin e dialogut me Serbinë gjatë qeverisjes së kaluar të Kurtit.

evoluar në të ashtuquajturin dialog politik. Kjo rezolutë e titulluar rezolutë për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë parashihte po ashtu rolin mbikëqyrës të Kuvendit dhe komisioneve përkatëse parlamentare ndaj dialogut. Mirëpo, për dallim nga rezoluta e parë në të cilën parashihej roli mbikëqyrës i Kuvendit dhe komisioneve, në këtë rezolutë parashihej edhe rol pjesëmarrës i komisioneve në dialog, krahas ekzekutivit.¹⁰ Nëse kjo do të shihej në kornizat e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të qershorit 2019 lidhur me Ligjin për Delegacionin Shtetëror për Dialogun,¹¹ një rol i tillë për komisionet parlamentare si pjesëmarrëse

në procesin e dialogut krahas Qeverisë, cenon parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Kjo në kuptimin që vetëm ekzekutivi ka kompetenca kushtetuese për zbatimin e politikës së jashtme, ndërsa legjislativi vetëm e mbikëqyrë atë.

Pavarësisht që procesi i dialogut vazhdoi nga viti 2012 dhe Kuvendi miratoi rezoluta të ndryshme lidhur me tema të ndryshme të ngritura në dialog, deri në vitin 2018 nuk u miratua ndonjë rezolutë për procesin e dialogut. Pas fillimit të fazës së re të dialogut në vitin 2017 rreth një vit më vonë, me 15 dhjetor të vitit 2018 në Kuvend u miratua

¹⁰ Rezolutë për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, 18 tetor 2012 në, http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezolute_Marredhenive_Kosova_Serbia.pdf

¹¹ Shih aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me Ligjin për Delgacionin Shtetëror në https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/06/ko_43_19_agj_shq.pdf

rezoluta e tretë mbi fazën finale të dialogut. Kjo rezolutë e iniciuar nga partia e atëhershme opozitare PSD parashihte ndër të tjera parimet e dialogut, themelimin e një delegacioni shtetëror për dialogun si dhe krijimin e një komisioni parlamentar për mbikëqyrjen e dialogut. Konkretisht në tekstin e kësaj rezolute ndër të tjera thuhej se delegacioni shtetëror për dialogun me Serbinë do të raportonte në mënyrë të rregullt në këtë komision. Ky komision do të përbëhej nga anëtarë të të gjitha subjekteve parlamentare si dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Për më tepër rezoluta parashihte që komisioni të udhëhiqej nga një përfaqësues i partive opozitare, pjesëmarrëse në procesin e dialogut. Pra edhe kjo rezolutë parashihte rol pjesëmarrës të opozitës në procesin e dialogut gjë që bie në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe kontrollit të pushteteve. Në qershor të vitit 2019 Gjykata Kushtetuese e kishte shpallur Ligjin për Delegacionin Shtetëror, që buronte nga kjo rezolutë, në kundërshtim me Kushtetutën, sepse kompetencat e delegacionit shtetëror të parapara me këtë ligj nuk ishin në pajtueshmëri me Kushtetutën.¹² Mundësia e krijimit të një komisioni për mbikëqyrjen e dialogut ishte përmendur edhe së fundi në platformën për dialogun të prezantuar nga kryeministri aktual Avdullah Hoti. Edhe në këtë platformë parashihej që ky komision të drejtohet nga opozita.¹³ Kjo ide është konsideruar si ndërhyrje e ekzekutivit në mandatin e Kuvendit, pasi vetëm Kuvendi vendosë për krijimin e trupave të tij mbikëqyrës ndaj ekzekutivit. Megjithatë, lidhur me materializimin e kësaj iniciative ende nuk është ndërmarrë ndonjë hap konkret.

Pas rezolutës së dhjetorit 2018, në Kuvend është miratuar edhe **rezoluta e katërt** lidhur me procesin e dialogut me Serbinë gjatë qeverisjes së kaluar të Kurtit. E iniciuar nga LDK dhe LVV dhe e miratuar nga Kuvendi më 15 mars 2020, kjo rezolutë shprehte përkushtimin e Kosovës për

dialog me Serbinë. Si dhe përcaktonte udhëheqjen e dialogut nga Qeveria në përputhje me Kushtetutën dhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me delegacionin shtetëror. Mirëpo në tekstin e saj nuk thuhej se udhëheqja e dialogut do të bëhej në koordinim/këshillim me Presidentin, ashtu siç e parashohin dispozitat kushtetuese dhe aktgjykimi i Gjykatës. Lidhur me rolin mbikëqyrës të Kuvendit në këtë rezolutë thuhej që Kuvendi përcakton që askush nuk ka të drejtë të bisedojë apo të negociojë lidhur me territorin e Kosovës.¹⁴

Në përgjithësi rezolutat e miratuara nga Kuvendi rreth dialogut me Serbinë nuk kanë arritur t'i garantojnë Kuvendit një mbikëqyrje efektive të këtij procesi. Si fillim, nuk ka pasur unitet politik në Kuvend për draftimin dhe miratimin e tyre. Edhe pse procesi i dialogut me Serbinë ka qenë një çështje e interesit nacional rreth së cilës spektri politik do duhej të ndërtonte një qëndrim unik kjo deri më tani nuk ka ndodhur. Rezolutat për dialogun janë iniciuar herë nga pozita e herë nga opozita dhe me raste të rralla ato janë përkrahur nga të dyja kampet. Rrjedhimisht vetë draftimi i rezolutave ka qenë më shumë shprehje e vullnetit të një grupacioni politik në Kuvend, përmbajtja e së cilës pastaj nuk ka qenë e pranueshme për pjesën tjetër të partive në Kuvend. Si rrjedhojë, propozimi dhe miratimi i rezolutave rreth dialogut është përcjellur me debate dhe mospajtime të shumta. Duke u bazuar në këtë, rezolutat rreth dialogut që propozohen nga ana e deputetëve në të ardhmen duhet të draftohen në atë mënyrë që të pranohen edhe nga pjesa tjetër e spektrit politik në Kuvend. Draftimit të rezolutave duhet ti paraprijë një debat më i gjerë mes partive parlamentare, i cili synon të përfshijë pikëpamjet e një spektri sa më të gjerë politik të përfaqësuar në Kuvend. Kjo duke pasur parasysh që dialogu është një proces që shkon përtej një partie politike apo grupi në Kuvend dhe se një rezolutë

12 Shih aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në, https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/06/ko_43_19_agj_shq.pdf

13 Shih deklaratën e kryeministrit Hoti në tryezën e KDI-së të mbajtur me 17 qershor 2020. Nga tryeza e KDI-së- Hoti: nuk ka kompromise të tjera, Kosova shkon në dialog vetëm për njohje në, <http://www.votaim.org/Public/DialogActivity/Detail/455>

14 Shih rezolutën për dialogun e miratuar me 15 mars 2020 në, http://www.votaim.org/Uploads/Data/Documents/Rezolutanr.07-R-001perbisedimet-dialogunKosove-Serbi_EH8KPbGXLw_GqTrrfntq.pdf

e mbështetur nga një shumicë më e gjerë parlamentare fuqizon vet impaktin e saj.

Deputetët duhet të sigurohen që rezolutat e propozuara rreth dialogut nuk iu mbivendosen rezolutave të miratuara në të kaluarën rreth dialogut. Ka pasur raste kur për çështje të njëjta janë miratuar disa rezoluta të ndryshme. Prandaj, në vend të kësaj deputetët duhet të ushtrojnë më shumë presion tek Qeveria që të zbatoj rezolutat që tashmë ka miratuar Kuvendi duke evituar mbivendosjen e rezolutave për të njëjtën çështje. Si dhe duhet të sigurohen që nga aspekti juridik përmbajtja e rezolutave nuk tejkalon mandatin mbikëqyrës të Kuvendit dhe nuk ndërhyjnë në mandatin e ekzekutivit, siç trajtohet në kapitullin në vijim.

2.2 Kuvendi përtej mandatit të tij mbikëqyrës ndaj dialogut me Serbinë

Siç u përmend më lart, disa nga rezolutat e miratuara kanë paraparë një rol të Kuvendit përtej mandatit mbikëqyrës të tij ndaj procesit të dialogut, duke i përcaktuar trupat e Kuvendit si pjesëmarrëse në dialog krahas ekzekutivit. Përveç tyre, Kuvendi kishte tejkaluar kompetencat e tij me emërimin e deputetit të Kuvendit nga radhët e AAK-së Blerim Shala si koordinator politik në dialog nga ish Presidentja Jahjaga me 22 nëntor 2012. Emërimi i tij ishte përcjellë me polemika pasi që partitë opozitare të asaj kohe LDK dhe LVV e kishin konsideruar këtë veprim si kundër kushtetues, pasi që deputetët nuk kishin të drejtë të usht-

ronin edhe role ekzekutive në të njëjtën kohë me mandatin e deputetit. Ndërsa AAK e cilësonte pozitën e koordinators politik si pozitë jo ekzekutive.¹⁵ Sidoqoftë rasti nuk ishte dërguar për interpretim në Gjykatën Kushtetuese, ndërsa z.Shala kishte vazhduar të ushtronte paralelisht edhe pozitën e deputetit dhe atë të koordinators politik për dialogun. Për më tepër pas zgjedhjeve në qershor të vitit 2014, z. Shala ishte rizgjedhur sërish deputet i Kuvendit dhe ishte bërë sërish pjesë e delegacionit të Qeverisë së Kosovës për bisedime me Serbinë të asaj kohe. Me propozim të PDK-së dhe LDK-së ai ishte votuar në Kuvend me 56 vota për, 4 abstenime dhe 1 votë kundër.¹⁶ Para votimit, deputeti i PDK-së Nait Hasani kishte tërhequr vërejtjen se Kuvendi po bënte sërish shkelje me emërimin e z. Shala pasi çështja e dialogut nuk i takonte Kuvendit por Qeverisë, përkatësisht ekzekutivit.¹⁷ Asnjë nga deputetët e tjerë nuk ishte lajmëruar për diskutim dhe as kësaj radhe nuk ishte kërkuar interpretim nga Gjykata Kushtetuese edhe pse z. Shala edhe kësaj radhe kishte vazhduar të mbante dy pozita, atë të deputetit dhe atë të anëtarit të delegacionit qeveritar për bisedime me Serbinë. Edhe në deklarinë e tij të pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK), figurojnë dy paga një nga Kuvendi dhe një nga Qeveria, e përshkruar si kontratë mbi vepër si dhe mëditjet për udhëtime.¹⁸

Duke u bazuar në këto praktika është me rëndësi që Kuvendi të ketë parasysh kompetencat e tij kushtetuese si institucion mbikëqyrës i politikës së jashtme. Në këtë drejtim rezolutat dhe aktet tjera të Kuvendit duhet të jenë në përputhje me mandatin e tij kushtetues, duke mos cenuar parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

15 Top Channel, 'Jahjaga shkeli Kushtetutën?', 25 dhjetor 2012 në <https://top-channel.tv/2012/12/25/jahjaga-shkeli-kushtetuten/>

16 Shih seancën e votimit në transkriptin e Kuvendit të datës 16 prill 2015 në http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2015_04_16_10_5890_al.pdf

17 Shih deklaratën e deputetit Nait Hasani rreth kësaj çështje fq. 53, në http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2015_04_16_10_5890_al.pdf

18 Shih deklarinë e pasurisë të z. Blerim Shala në AKK në Viti 2014: https://akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Deklarimi%20i%20Pasurise/Deklarimet/declaration/2014/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Blerim_Shala.pdf, 2015: https://akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Deklarimi%20i%20Pasurise/Deklarimet/declaration/2015/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Blerim_Shala.pdf dhe 2016: https://akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Deklarimi%20i%20Pasurise/Deklarimet/declaration/2016/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Blerim_Shala.pdf

3. TEMA E DIALOGUT NË KUVEND: TEJKALIMI I DALLIMEVE PARTIAKE DHE FOKUSI TEK TRANSPARENCA E DIALOGUT

Procesi i dialogut me Serbinë ka qenë një nga shkaqet kryesore të mospajtimeve dhe debateve në Kuvend. Që kur kishte filluar ky proces në vitin 2011, partitë politike kishin shprehur mospajtimet e tyre për fillimin e këtij procesi, vazhdimin e tij dhe marrëveshjet e arritura. Procesi i ratifikimit të marrëveshjes së parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë e arritur me 19 prill 2013, ishte zhvilluar me kundërshtime në Kuvend dhe protesta në rrugë.¹⁹ Një marrëveshje tjetër e cila ishte përcjellë me polemika në Kuvend ishte edhe ajo për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe e arritur me 25 gusht 2015. Kjo marrëveshje dhe ajo për demarkacionin me Malin e Zi e nënshkruar në të njëjtën kohë shkaktuan përplasje të ashpra në Kuvend, përdorim të gazit lotsjellës e bojkotim të punës së Kuvendit. Kryeministri i asaj kohe Isa Mustafa ishte penguar që të raportonte para deputetëve për marrëveshjen e Asociacionit.

Edhe faza e re e dialogut e cila filloi në fund të vitit 2017 ishte përcjellë me debate në Kuvend. Fillimisht kryeministri i asaj kohe Ramush Haradinaj ia kishte deleguar kompetencat e tij Presidentit për të udhëhequr vetë me

dialogun, gjë që kishte pamundësuar rolin mbikëqyrës të Kuvendit, pasi që ky i fundit nuk kishte mandat për të ftuar në raportim Presidentin. Për më tepër, Presidenti gjatë kësaj kohe po mbështeste idenë e korrigjimit të kufijve për të cilën nuk kishte përkrahje politike e qytetare brenda vendit. Lidhur me këtë, mospajtimet partiake ia pamundësuan Kuvendit që të miratonte një rezolutë e cila kishte për qëllim të ia ndalonte presidentit diskutimet për territorin. Kur qeveria e asaj kohe e udhëhequr nga Ramush Haradinaj arriti të sigurote votat në Kuvend për krijimin e një Delegacioni Shtetëror për Dialogun, e cila do të përfaqësonte Kosovën në dialog krahas Presidentit, Ligji për themelimin e këtij ekipi hodh poshtë nga Gjykata Kushtetuese mbi arsyetimin se cenonte parimin e ndarjes së pushteteve. As tarifa 100% ndaj Serbisë që ishte vendim i ish Qeverisë Haradinaj dhe as zëvendësimi i saj me masa të reciprocitetit nga ish Qeveria Kurti nuk kishte gjetur mbështetje të gjerë politike në Kuvend. Edhe periudha pas këtyre zhvillimeve është karakterizuar me polemika dhe mospajtime të thella në Kuvend lidhur me dialogun. Rifillimi i dialogut nën udhëheqjen e Qeverisë Hoti është karakterizuar me paqartësi dhe mungesë të transpar-

¹⁹ Evropa e Lirë, Ratifikim dhe protesta për marrëveshjen Kosovë - Serbi , 25 qershor 2013 në, <https://www.evropaelire.org/a/25027683.html>

Procesi i dialogut me Serbinë ka qenë një nga shkaqet kryesore të mospajttimeve dhe debateve në Kuvend. Që kur kishte filluar ky proces në vitin 2011, partitë politike kishin shprehur mospajtimet e tyre për fillimin e këtij procesi, vazhdimin e tij dhe marrëveshjet e arritura.

encës. Edhe pse kryeministri Hoti ka raportuar në Kuvend rreth takimeve të zhvilluara në kuadër të dialogut ai nuk ka ofruar detaje konkrete rreth temave të diskutimit dhe kërkesave të Kosovës dhe ndaj Kosovës në këtë proces. Qeveria nuk e ka sjellur ende në Kuvend as platformën për dialogun dhe e njëjta nuk është bërë ende publike në faqen zyrtare të Qeverisë.

Në përgjithësi këto zhvillime kanë dëshmuar polarizimin e skajshëm mes partive parlamentare lidhur me temën e dialogut. Debatet për konsum publik dhe kalkulimet partiake kanë mbizotëruar diskursin rreth dialogut. Duke pasur parasysh që çështja e dialogut me Serbinë shkon përtej interesave partiake, partitë parlamentare duhet të tentojnë të ndërtojnë një qëndrim të përbashkët lidhur me qasjen ndaj Serbisë dhe dialogut në veçanti. Një qëndrim i përbashkët i një spektri më të gjerë politik do të fuqizonte vet rolin mbikëqyrës të Kuvendit ndaj procesit të dialogut. Në këtë mënyrë fokusi do të zhvendosej nga dallimet politike rreth dialogut tek kërkesa e Kuvendit për transparencë dhe llogaridhënie të ekzekutivit lidhur me dialogun. Kjo duke pasur parasysh që në përgjithësi, procesi i arritjes së marrëveshjeve me Serbinë është shoqëruar

me mungesë të transparencës dhe pothuajse gjithmonë Kuvendi është njoftuar me përmbajtjen e marrëveshjeve, vetëm pasi ato janë arritur dhe janë publikuar. Mungesa e transparencës ka rrjedhur edhe nga vetë natyra e procesit të dialogut, i cili që nga fillimi është zhvilluar me një dozë konfidencialiteti. Po ashtu, qasja e BE-së që interpretimi i marrëveshjeve të lihet në diskrecion të palëve ka shkakuar konfuzion në kuptueshmërinë e përmbajtjes së marrëveshjeve. Si rrjedhojë, edhe Kuvendi i Kosovës si organi më i lartë mbikëqyrës i politikës së jashtme ka qenë i kufizuar në mbikëqyrjen e këtij procesi. Në kuadër të dialogut deri më tani janë arritur rreth 38 marrëveshje prej të cilave vetëm një prej tyre është ratifikuar në Kuvend, konkretisht Marrëveshja e Parë e Parimeve për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë e arritur në Bruksel me 19 prill të vitit 2013. Marrëveshjet para saj ishin quajtur konkluzat, ndërsa ato që u arritën pas saj derivate, letra të qëllimit e zotime dhe rrjedhimisht ende mbetet i paqartë statusi i tyre juridik. Lidhur me këtë, njohësit juridik kanë vlerësuar që vet Kuvendi duhet të analizojë formën dhe tekstin e çdo marrëveshjeje para se ta konsideroj një instrument për ratifikim.

Aktiviteti mbikëqyrës i Kuvendit ndaj dialogut me Serbinë deri më tani është materializuar kryesisht përmes miratimit të rezolutave për dialogun si dhe përmes mekanizmave tjerë mbikëqyrës si pyetjet parlamentare, debatet, interpelancat dhe thirrja në raportim e përfaqësuesve të ekzekutivit. Pavarësisht kësaj, është varur nga vullneti i ekzekutivit se sa informacione i ka ofruar deputetëve të Kuvendit lidhur me dialogun. Për më tepër ka pasur marrëveshje që janë publikuar me vonesë nga ana e ekzekutivit siç ka qenë rasti me marrëveshjen e drejtësisë. Raportimet e ekzekutivit në Kuvend lidhur me dialogun janë karakterizuar me informacione sipërfaqësore pa ofruar detaje konkrete lidhur me përmbajtjen e procesit. Në anën tjetër edhe deputetët e Kuvendit nuk kanë arritur që të marrin informacione të mjaftueshme rreth dialogut nga ana e përfaqësuesve ekzekutiv. Kjo kryesisht për shkak të përgatitjes së pakët të vetë deputetëve rreth kësaj teme. Deputetët kanë realizuar fare pak hulumtime paraprake lidhur me temat e ndërlidhura me dialogun gjë që është reflektuar në pyetjet drejtuar ekzekutivit. Në kuadër të fushëveprimit të tyre komisionet parlamentare kanë shfrytëzuar pak ekspertizën profesionale rreth temave të ndryshme, përmes kërkesave për hulumtime parlamentare. Në këtë drejtim deputetët kanë mundësinë që të kërkojnë më shumë realizim të hulumtimeve tek Drejtoria e Kuvendit për Hulumtime, Biblioteke dhe Arkiv (DHBA)²⁰, si dhe hulumtime të jashtme të organizatave të shoqërisë civile, në kuadër të projekteve për fuqizimin e Kuvendit.²¹

Që nga fillimi i dialogut në vitin 2011, tema e dialogut është diskutuar në disa nga seancat dhe mbledhjet e Komisioneve. Temat më të diskutuara në dy legjislaturat e fundit kanë

qenë marrëveshja e parë e parimeve për normalizimin e marrëdhënieve, Asociacioni i komunave me shumicë serbe, personat e pagjetur, marrëveshja e drejtësisë, ideja e korigjimit të kufijve, tarifa 100% ndaj Serbisë, delegacioni shtetëror për dialogun etj. (Shih Tabelën 1.1) Deputetët e Kuvendit nuk kanë shfrytëzuar sa duhet pyetjet parlamentare ndaj ekzekutivit lidhur me dialogun. Në sesionin pranveror 2019 dhe 2020, nga numri i përgjithshëm i pyetjeve të parashtruara të deputetëve ndaj ekzekutivit, vetëm 5% prej tyre kanë qenë lidhur me dialogun. Po ashtu, ka pasur pak ftesa për raportim ndaj ministrave lidhur me dialogun, ku gjatë dy sesioneve të fundit janë ftuar vetëm gjashtë ministra, mesatarisht tre ministra për sesion. Deputetët duhet të parashtrorin më shumë pyetje lidhur me dialogun në mënyrë që të mund të marrin informacionet e nevojshme nga ana e ekzekutivit. Si dhe duhet të ftojë ministrat përkatës në raportim sa herë ka zhvillime në gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve të kaluara të dialogut, pas arritjes së marrëveshjeve të reja dhe temat që diskutohen në kuadër të vazhdimin të dialogut.

Në përgjithësi tema e dialogut është diskutuar më shumë në seanca të Kuvendit dhe më pak në mbledhje të komisioneve.²² Gjatë vitit 2018 periudhë kjo kur çështja e të ardhmes së dialogut ka qenë një ndër temat qendrore, deputetët kanë qenë mjaftë aktiv në diskutimin e kësaj teme në seanca, duke e ngritur këtë çështje në 50% të seancave të Kuvendit. Ndërsa, është ngritur si çështje në vetëm 12% të mbledhjeve të komisioneve, prej të cilave në vetëm 3% të këtyre mbledhjeve, kjo temë kanë qenë pjesë e rendit të ditës.²³ Edhe së fundi, gjatë sesionit pranveror 2019 dhe atij 2020 është vërejtur një dinamikë më e madhe e dis-

20 Hulumtimet Legjislative në, <http://www.kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/hulumtimet-legjislative/>

21 Me kërkesë të deputetëve, disa nga hulumtimet tematike janë realizuar edhe nga KDI në kuadër të projektit të USAID-it Mbështetje aktiviteteve të jashtme për hulumtime parlamentare si dhe projektit Për fuqizimin e mbikëqyrjes parlamentare ndaj qeverisë dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e dialogut Kosovë - Serbi , i mbështetur nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë.

22 KDI, Raport: Dialogu Kosovë-Serbi gjatë vitit 2018 në Kuvendin e Kosovës, fq.5 në, [file:///C:/Users/KDI/Downloads/DialoguKosove-Serbigjatevitit2018neKuvendineKosoves_wwagnhsUUG%20\(3\).pdf](file:///C:/Users/KDI/Downloads/DialoguKosove-Serbigjatevitit2018neKuvendineKosoves_wwagnhsUUG%20(3).pdf)

23 Shih raportin Dialogu Kosovë-Serbi gjatë vitit 2018 në Kuvendin e Kosovës në, [file:///C:/Users/KDI/Downloads/DialoguKosove-Serbigjatevitit2018neKuvendineKosoves_wwagnhsUUG%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/KDI/Downloads/DialoguKosove-Serbigjatevitit2018neKuvendineKosoves_wwagnhsUUG%20(1).pdf)



kutimeve rreth dialogut në seanca në krahasim me komisionet. Gjatë kësaj periudhe, dialogu është diskutuar në rreth 45% të seancave dhe në vetëm 10% të mbledhjeve të komisioneve.

Zakonisht, për shkak edhe të gamës së gjerë të çështjeve që janë në fushëveprimin e tyre, komisionet nuk kanë trajtuar sa duhet çështjet që ndërlidhen me dialogun Kosovë-Serbi. Dialogu dhe çështjet e ndërlidhura me të, janë trajtuar nga një numër i vogël i komisioneve parlamentare, ndër të cilat është vërejtur një rol i shtuar i komisionit parlamentar për punë të jashtme. Në kuadër të aktiviteteve mbikëqyrëse komisionet parlamentare ndonjëherë kanë realizuar edhe vizita në terren për të monitoruar nga afër gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit. Shumica e këtyre vizitave janë realizuar me mbështetje të KDI-së²⁴, mirëpo ka pasur raste kur komisionet kanë ndërmarrë vetë iniciativa për vizita në terren lidhur me dialogun. E tillë ka qenë ajo e realizuar në Luginën e Preshevës nga komisioni për arsim dhe ai për administratë publike më 5 qershor 2019.²⁵ Këto vizita më pas janë përcjellur me rezoluta në Kuvend dhe kërkesa për raportime ndaj ekzekutivit, për të kërkuar transparencë dhe llogaridhënie lidhur me informacionet e marra nga vizita në terren. Këtë e ka bërë komisioni parlamentar për zhvillim ekonomik, i cili pas vizitës në terren të organizuar me 22 mars 2018 në kompaninë publike për energji KOSTT²⁶ ka ftuar më pas në raportim institucionet zbatuese të kësaj marrëveshje, më 26 nëntor 2018.²⁷ Ndërsa pas vizitës në terren, në Kuvend është iniciuar edhe një rezolutë lidhur me këtë çështje dhe e njëjta është miratuar më 5 qershor 2018.²⁸ Mirëpo në

përgjithësi numri i vizitave në terren lidhur me dialogun ende mbete i ulët.

Përgjatë sesionit pranveror të këtij viti, Kuvendi i Kosovës ka pasur performancë të dobët si në ligjvënien ashtu edhe në mbikëqyrje, për shkak të situatës politike dhe asaj rrethanave që u krijuan si rezultat i pandemisë COVID 19. Si rrjedhojë, sesioni vjeshtor është i ngarkuar me aktivitete ligjvënëse, por edhe mbikëqyrëse, meqenëse Qeveria ka paraparë dërgimin e një numri të madh të projektligjeve për shqyrtim, veçanërisht në muajt e fundit të këtij viti. Trajtimi i këtyre projektligjeve padyshim që do të ndikojë edhe punën dhe performancën e komisioneve parlamentare, të cilat do të kenë dukshëm më pak kohë në dispozicion për ushtrimin efektiv të rolit mbikëqyrës, veçanërisht në raport me dialogun Kosovë-Serbi. Në këto rrethana komisionet duhet të planifikojnë me kohë aktivitetet mbikëqyrëse ndaj dialogut duke i paraparë ato edhe në planet e tyre të punës dhe gjatë përditësimit të këtyre planeve në fillim të sesioneve punuese. Si institucion mbikëqyrës Kuvendi ka nevojë për më shumë koordinim rreth temës së dialogut. Në këtë drejtim komisionet parlamentare duhet të vazhdojnë praktikën e mirë të organizimit të *takimeve koordinuese* mes vete, të mbështetur nga KDI që nga viti 2016 por edhe me vetiniciativë të komisioneve. Këto takime shërbejnë si një platformë diskutimi dhe bashkërendimi në mes të komisioneve parlamentare për fuqizimin e rolit mbikëqyrës ndaj dialogut. Si dhe me qëllim të avancimit të transparencës së këtij procesi, duke u bazuar në rezolutat paraprake të Kuvendit për këtë çështje.²⁹

24 Që nga viti 2016, KDI në bashkëpunim me ë parlamentare ka realizuar shtatë vizita në terren për të monitoruar nga afër gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit. Shih detajet në, <http://www.votaim.org/Public/DialogActivity>

25 Telegrafi, Deputetët e Kosovës vizitojnë tri komunat e Luginës së Preshevës, 5 qershor 2019 në, <https://telegrafi.com/deputetet-e-kosoves-vizitojne-tri-komunat-e-lugines-se-presheves/>

26 Shih detajet e kësaj vizite në, <http://www.votaim.org/Public/DialogActivity/Detail/177>

27 Shi detajet nga ky raportim në, <http://www.votaim.org/Public/DialogActivity/Detail/257>


28 Shih përmbytjen e rezolutës për situatën në energji në, http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/2018_06_11_Rezoluta%20nr.06-R-008.pdf

29 Shih detajet nga të gjitha takimet koordinuese në mes të komisioneve parlamentare në, <http://www.votaim.org/Public/DialogActivity>





Gjatë vitit 2018 periudhë kjo kur çështja e të ardhmes së dialogut ka qenë një ndër temat qendrore, deputetët kanë qenë mjaftë aktiv në diskutimin e kësaj teme në seanca, duke e ngritur këtë çështje në



50%

të seancave të Kuvendit.

Ndërsa, është ngritur si çështje në vetëm

12% → 3%

të mbledhjeve të komisioneve, prej të cilave në vetëm

të katër mbledhjeve, kjo temë kanë qenë pjesë e rendit të ditës.

Në fund, deputetët e Kuvendit duhet të sigurohen që të shfrytëzojnë në mënyrë sa më efektive të gjithë mekanizmat mbikëqyrës në dispozicion. Në mënyrë që të fuqizohet mbikëqyrja parlamentare ndaj dialogut, deputetët duhet të konsiderojnë kombinimin e mekanizmave mbikëqyrës parlamentar. Në këtë drejtim kërkesat për transparencë dhe llogaridhënie ndaj Qeverisë mund të fillojnë me pyetje parlamentare, kërkesa për raportim në komision, për tu zgjeruar më pas në kërkesa për debat

parlamentar, interpelanca dhe rezoluta të Kuvend për çështjen në fjalë. Rrjedhimisht mbikëqyrja ndaj dialogut duhet të bëhet në mënyrë efektive dhe sistematike deri në përmbushjen e misionit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj ekzekutivit.

4. PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME

Që nga fillimi i dialogut Kosovë- Serbi, Kuvendi ka ushtruar rolin e tij mbikëqyrës përmes miratimit të rezolutave rreth dialogut dhe mekanizmave tjerë mbikëqyrës si pyetjet parlamentare, debatet parlamentare, interpelancat dhe ftesat në raportim të ministrave. Në përpjekjet e tij për të garantuar transparencë të procesit të dialogut, Kuvendi disa herë ka tejkalar rolin e tij mbikëqyrës duke ndërhyrë në mandatin e ekzekutivit. Kompetencat kushtetuese të Kuvendit dhe institucioneve tjera janë sqaruar përfundimisht me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me Delegacionin Shtetëror. Rezolutat e miratuara nga Kuvendi rreth dialogut shpesh herë i janë mbivendosur njëra tjetër duke u miratuar kështu disa rezoluta për çështjen e njëjtë.

Tema e dialogut ka qenë dhe mbetet një nga shkaqet kryesore të mospajtimeve mes partive politike. Debatet e ashpra në Kuvend, përdorimi i gazit lotsjellës dhe bojkotimi i seancave kanë pasur si objekt temën e dialogut me Serbinë. Vazhdimi i dialogut nën ndërmjetësimin e SHBA-ve dhe të Bashkimit Evropian sërish ka vënë në pah polarizimin e spektrit politik për dialogun. Procesi po vazhdon me praktikata e kaluara të mungesës së transparencës. Edhe pse kryeministri ka raportuar disa herë në Kuvend lidhur me takimet në Uashington dhe Bruksel, ai është rezervuar në dhënien e informacioneve lidhur me të gjitha temat që pritet të diskutohen në procesin e dialogut. Qeveria nuk e ka sjellur ende në Kuvend as platformën për dialogun dhe e njëjta nuk është bërë ende publike në faqen zyrtare të Qeverisë.

Nga ana statistikore, tema e dialogut është diskutuar më shumë në seanca të Kuvendit dhe më pak në mbledhje të komisioneve parlamentare. Si arsye për këtë duket të jetë numri i madh i çështjeve tjera që bien në fushëveprimin e komisioneve, duke ua pamundësuar këtyre të fundit që ti kushtojnë vëmendje të veçantë çështjeve që ndërlidhen me dialogun.

Në përgjithësi, mbikëqyrja parlamentare ndaj dialogut mund të përmirësohet më tutje dhe Kuvendi duhet të shfrytëzojë në mënyrë më efektive mekanizmat mbikëqyrës në dispozicion për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie të ekzekutivit lidhur me dialogun.



Për të fuqizuar mbikëqyrjen parlamentare ndaj dialogut, KDI rekomandon që deputetët e Kuvendit të ndërmarrin hapat e mëposhtëm:

- **Rritja e numrit të pyetjeve parlamentare:** Deputetët e Kuvendit duhet që të parashtrojnë më shumë pyetje parlamentare ekzekutivit lidhur me dialogun në përgjithësi dhe temat e diskutimit në veçanti.
- **Organizimi i debateve dhe interpelancave:** Deputetët e Kuvendit duhet të organizojnë më shumë debate parlamentare lidhur me dialogun dhe të ftojnë në interpelancë kryeministrin dhe ministrat përkatës lidhur me dialogun në përgjithësi dhe aspekte të veçanta të dialogut. Deputetët duhet të sigurohen që informacionet e reja të siguruar nga debatet dhe interpelancat të përcjellën me kërkesa ndaj ekzekutivit përmes mekanizmave tjerë mbikëqyrës në dispozicion si rezolutat dhe raportimet në komisione dhe seanca.
- **Rezolutat rreth dialogut:** Deputetët e Kuvendit duhet të sigurohen që propozimi i rezolutave të reja për një çështje të caktuar të ndërlidhur me dialogun të mos u mbivendoset rezolutave të kaluara rreth të njëjtës çështje, të miratuara nga Kuvendi.
- **Rritja e raportimeve të ekzekutivit:** Deputetët e Kuvendit duhet të shpeshtojnë ftesat në raportim rreth dialogut ndaj kryeministrit dhe ministrave në seanca dhe në komisione.
- **Diskutime tematike rreth dialogut në Komisione:** Komisionet duhet të përfshijnë temën e dialogut në mënyrë konkrete në planet e tyre të punës. Komisionet përkatëse duhet të organizojnë diskutime tematike gjatë mbledhjeve të rregullta dhe dëgjime publike, lidhur me pjesë specifike të marrëveshjes së Uashingtonit dhe temave në Bruksel, sipas fushëveprimit të komisioneve.
- **Organizimi i vizitave në terren:** Komisionet duhet të organizojnë vizita në terren për të monitoruar nga afër gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve të kaluara të dialogut dhe marrëveshjet e reja.
- **Takimet koordinuese në mes komisioneve:** Komisionet duhet të vazhdojnë praktikën e mirë të organizimit të takimeve koordinuese mes tyre, si platformë e bashkërendimit dhe koordinimit në mbikëqyrjen e dialogut.
- **Realizmi i hulumtimeve parlamentare:** Komisionet duhet të shfrytëzojnë më shumë mundësinë e realizmit të hulumtimeve parlamentare për tema të caktuara të procesit të dialogut, përmes Kuvendit dhe shoqërisë civile. Si dhe të shfrytëzojnë hulumtimet/raportet tashmë të publikuara nga OJQ-të dhe ekspertët e kësaj fushe.





Shtojcë 1: Mbikëqyrja Parlamentare e dialogut në numra

Tabela 1.1: Mbikëqyrja parlamentare ndaj Dialogut Kosovë-Serbi 2014-2019

Dialogu në Seanca dhe Komisione	Në Legjislaturën e Pestë (2014 -2017)	Në Legjislaturën e Gjashtë (sesioni pranveror dhe vjeshtor 2018)	Në Legjislaturën e Gjashtë (sesioni pranveror (janar – gusht 2019)	Në Legjislaturën e Shtatë (sesioni pranveror (janar – gusht 2020)
Diskutime për dialogun në Seanca	63 seanca 	43 seanca 	14 seanca 	11 seanca
Dialogu si pikë e rendit të ditës	23 seanca 	24 seanca 	22 seanca 	6 seanca
Temat më të diskutuara rreth dialogut në seanca	Marrëveshja e Parë e Parimeve për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, Asociacioni i Komunave me shumicë serbe, strukturat paralele serbe, personat e pagjetur dhe marrëveshja për drejtësinë	Ideja e korrigjimit të kufijve/ shkëmbimi i territoreve, Ligji 06/L-për Delegacionin Shtetëror, Platforma për Dialogun, taksa 100%, reciprociteti ndaj Serbisë, si dhe dënimi i gjenocidit serb të kryer në Kosovë, çështja e energjisë, personat e zhdukur, Marrëveshja për Telekomunikacion, mungesa e transparencës në dialog dhe marrëveshja e Parë e Parimeve e vitit 2013.	Korrigjimi i kufijve, Ligji për Delegacionin Shtetëror dhe Platforma për Dialogun, taksa 100%, reciprociteti dhe gjenocidi serb i kryer në Kosovë.	Tarifa 100% ndaj Serbisë, reciprociteti ndaj Serbisë dhe modalitetet e rifillimit të procesit të dialogut.
Debate Parlamentare për dialogun	4	4	1	3
Interpelanca për dialogun	3	1	0	1
Rezoluta për dialogun	4	3	1	1





Dialogu në Seanca dhe Komisione	Në Legjislaturën e Pestë (2014 -2017)	Në Legjislaturën e Gjashtë (sesioni pranveror dhe vjeshtor 2018)	Në Legjislaturën e Gjashtë (sesioni pranveror (janar – gusht 2019)	Në Legjislaturën e Shtatë (sesioni pranveror (janar – gusht 2020)
Pyetje Parlamentare për dialogun	28	16	7	2
Diskutimet për dialogun në mbledhje të komisioneve	115	62	18	18
Dialogu si pikë e rendit të ditës në mbledhje të komisioneve	27	33	20	1
Temat më të diskutuara rreth dialogut në komisione	Fondi për veriun, marrëveshja e drejtësisë, marrëveshja e parë e parimeve, marrëveshja e diplomave, telekomi, energjia, asociacioni dhe personat e zhdukur.	Marrëveshja e energjisë, marrëveshja e drejtësisë, fushata lobuese e Serbisë, personat e zhdukur, Ligji për Delegacionin Shtetëror, taksa 100% dhe marrëveshja për telekomunikacionin.	Ligji për Delegacionin Shtetëror, taksa 100%, pengesat e Serbisë në subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës, marrëveshja për telekomunikacionin dhe personat e pagjetur.	Fushata e çnjohjeve nga Serbia, rifillimi i procesit të dialogut dhe marrëveshja e energjisë.
Raportimet e ministrave në komisione	11	9	4	2



Shtojcë 2: Marrëveshjet e dialogut sipas fushëveprimit të Komisioneve Parlamentare

Tabela 1.2: Marrëveshjet e dialogut sipas fushëveprimit të Komisioneve Parlamentare

Komisioni	Marrëveshjet e Dialogut
3. Komisioni për Buxhet dhe Transfere	Marrëveshja e Uashingtonit, IBM, Vulat Doganore , Mbledhja e të hyrave doganore
4. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim	Marrëveshja e Parë e Parimeve, Asociacioni i Komunave me shumicë serbe
1. Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit	Marrëveshja e Parë e Parimeve, Asociacioni i Komunave me shumicë serbe, Marrëveshja për Drejtësi
2. Komisioni për Integrim Evropian	Marrëveshja e Uashingtonit, Lëvizja e Lirë, Përfaqësimi dhe Bashkëpunimi Rajonal, IBM
5. Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë	Marrëveshja e Uashingtonit, Lëvizja e Lirë, Përfaqësimi dhe Bashkëpunimi Rajonal, Zyrtarët ndërlidhës, Vizitat Zyrtare , Marrëveshja e Parë e Parimeve
6. Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport	Marrëveshja e Uashingtonit, Njohja reciproke e Diplomave
8. Komisioni për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike	Marrëveshja e Uashingtonit, Lëvizja e Lirë, Përfaqësimi dhe Bashkëpunimi Rajonal, IBM, Vulat Doganore, Energjia, Telekom, Njohja e certifikatave ADR, Sigurimi i Automjeteve
11. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë dhe Mjedis	Marrëveshja e Uashingtonit, Ura e Mitrovicës
10. Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	Marrëveshja për barnat



Komisioni	Marrëveshjet e Dialogut
7. Komisioni për Qeverisje Lokale, Administratë Publike, Zhvillim Rajonal dhe Media	Regjistrat Civil, Regjistrat Kadastral, Lëvizja e Lirë
9. Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes	Lëvizja e Lirë, IBM, Shpërbërja e Mbrojtjes Civile, Ura e Mitrovicës, Njohja e certifikatave ADR, strukturat Paralele
12. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione	Marrëveshja e Uashingtonit, Marrëveshja e Parë e Parimeve, Lëvizja e Lirë
13. Komisioni për Mbiqëqyrjen e Financave Publike	Marrëveshja e Uashingtonit, Mbledhja e të hyrave doganore
14. Komisioni për Mbiqëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë	Shpërbërja e Mbrojtjes Civile, strukturat paralele



Përkrahur nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA



german
cooperation

DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT